



Dep. <u>DPK</u> Dep. <u>DPK</u> Nr. i faq. <u>03</u> Broj stranica <u>03</u> Nr. pages <u>03</u>	Nr. Prot. <u>03-03-4869/16</u> Prot No. <u>03-03-4869/16</u> Data <u>27.12.2016</u> Datum <u>27.12.2016</u> Date <u>27.12.2016</u>

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	27.12.2016
REFERENC-Ë:	AKK-DPKPP
PËR/ZA/TO:	z. Mehmet Rama Zyrtari i Prokurimit në Komunën e Drenasit
CC:	z. Arsim Haxhiu Nënkryetar i Komunës së Drenasit
NGA/OD/FROM:	Shaip Havolli Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me tenderin " Rregullimi dhe izolimi i kulmit në SHFMU-Dobroshevc dhe renovimi i objekteve të banimit social"



I nderuari z. Rama

Në mbështetje të nenit 142 par. 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 par. 1, nënpar. 1.1. dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 8 par. 4, 9 par. 1, nënpar. 1.6, 12 par. 2 dhe 19 par. 1, nënpar. 1.6 të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, si dhe të nenit 23 të Rregullores nr. 01/2014 së Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me Tenderin me titull " Rregullimi dhe izolimi i kulmit ne SHFMU-Dobroshevc dhe renovimi i objekteve të banimit social " me numër prokurimi 611 13 128 521, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

O P I N I O N

Kërkohet nga ju si autoritet kontraktues (në tekstin e mëtejshëm A.K), që t'i ndërmerri të gjitha veprimet e nevojshme për evitimin e shkeljeve të evidentuara në lidhje me tenderin " Rregullimi dhe izolimi i kulmit ne SHFMU-Dobroshevc dhe renovimi i objekteve të banimit social " në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr.04 – L/042 për Prokurimin Publik atëherë kur ky aktivitet i prokurimit të ritenderohet.

A r s y e t i m

Departamenti i Prokurimit në Komunën e Drenasit ka përgatitë Njoftimin për Kontratë me titull " Rregullimi dhe izolimi i kulmit në SHFMU-Dobroshevc dhe renovimi i objekteve të banimit social " me numër prokurimi: 611 13 128 521, e cila është publikuar në faqen elektronike të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik në Procedurë të Hapur.

Pas pranimit të informacionit përfaqësues zyrtarët nga Agjencia kane vizituar objektin e shkollës SHFMU-Dobroshevc dhe janë takuar me drejtorin e shkollës, ku janë vizituar të gjitha klasat dhe po thuaj se të gjitha tavanet ishin me lagështi, një ere e tmerrshme në tërë objektin. Në bisede e sipër drejtori i kësaj shkolle na informojë se i kemi lajmëruar ata në komune dhe jemi duke i pritur për ta rregulluar. Kemi bërë edhe fotografi të klasave në përcjelljen e drejtorit dhe arsimtarët të cilët zhvillojnë mësimin në ato kushte të tmerrshme.

Agjencia konstaton se autoriteti kontraktues konkretisht njësia e kërkesës drejtoria për arsim me të drejte dhe sipas nevojave ka bërë kërkesë për shpalljen e tenderit por para masa dhe parrallogaria nuk ka qenë të qarta, të sakta dhe precize dhe kane krijuar dyshime rreth punëve që do të kryhen në aktivitetin e prokurimit me titull "Rregullimi dhe izolimi i kulmit ne SHFMU" RILINDJA DRITAN-DRENAS.

Agjencia ka ftuar në takim zyrtarin e prokurimit të autoriteti kontraktues për të sqaruar këtë parregullsi dhe nga ai kemi kuptuar se kjo paramasë është punuar nga drejtoria e arsimit dhe duhet sqaruar me zyrtarin përgjegjës nga njësia e kërkesës. Në dokumentin e paramasës të datës 04.10.2016 gjendet nënshkrimi i zyrtarës e cila ka punuar paramasën dhe paralogari, nga kjo kuptojmë se edhe zyra e prokurimit nuk ka bërë asnjë hape që të verifikojë këtë para masë se a është konforme objektit të kontratës.

Pas reagimit dhe vërejtjes nga ana e Agjencisë, zyra e prokurimit ka bërë shtyrjen e afatit për hapjen e tenderit dhe janë njoftuar të gjithë OE që kane tërhequr dosjen e tenderit se do të këtë korrigjime në paramasën dhe para llogarinë nga kompania e kontraktuar për këtë specifikacion. Në para masën për kryerjen e punëve të cilinë e ka punuar kompania projektuese kemi **RIKONSTRUIMI I SHKOLLES "RILINDJA" NE FSHATIN DOBROSHEC-KK DRENAS**, duke përfshirë këto pozicione të punëve të cilat duhet të kryhen si: punët përgatitore, punët demoluese, punët e zhavorrit, punët e betonit dhe kupëzave, punët e nivelizimit, punët e zdrukthëtarisë dhe punët e ndryshme. Dosjen e

tenderit e kanë tërhequr 10 operator ndërsa ofertat e tyre i kanë dorëzuar vetëm 6 ofertues për dy llotot, ndërsa njoftimi për monitorim është dërguar në autoritetin kontraktues me datën 01.12.2016.

Agjencia gjatë procesit të vlerësimit ka identifikuar se në dosjen tenderit e cila është modifikuar nga zyra e prokurimit pas shtyrjes së afatit kriteret e përcaktuara në njoftimin për kontrate dhe në dosjen e tenderi nuk janë në pajtueshmëri, konkretisht është shtuar edhe një kërkesë obligative lidhur me planin dinamik të kryerjes së punëve tek kapaciteti teknik e cila nuk ka qene e përfshirë në njoftimin për kontrate e as në dosjen e tenderit të përgatitur me datën 24.10.2016.

Tenderët e paraqitur nga operatorët ekonomike janë vlerësuar, ekzaminuar dhe krahasuar nga komisioni vlerësues në përbërje të plotë dhe të monitorua nga përfaqësuesi i Agjencisë. Komisioni vlerësues procesin e vlerësimit e ka kryer duke pasur për bazë kërkesat obligative të SEKSIONI II-flete e të dhëna të dosjes së tenderit dhe pas vlerësimit ka konstatuar e se asnjë nga operatorët ekonomike që kanë dorëzuar tenderët për dy llotet nuk kanë qenë në pajtueshmëri me kërkesat teknike të përcaktuara në dosjen e tenderit. Konkretisht asnjë nga operatorët nuk ka ofruar dëshminë lidhur me kërkesën teknike të paraqitur në nenin 9.1 të seksioni i dosjes së tenderit tek pika b) të paraqiten pajisjet/raportet për mjete-stabilimentet që janë në dispozicionin tuaj për realizimin e projektit.

Sipas raportit vlerësues të datës 01.12.2016 për të dy llotot komisioni vlerësues në mënyrë unike ka vendosur që tenderi në mungesë të ofertave të përgjegjshme të anulohet, të cilin rekomandim e ka aprovuar edhe zyrtari i prokurimit dhe ka bërë njoftimin për anulim të tenderit në web të KRPP-se.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues të cekura më lartë, konsiderojmë se bien ndesh me nenin 27 Dosja e Tenderit, nenin 28 Specifikimet teknike të Ligjit për Prokurimin Publik Nr.04/L-042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-237, nenin 10 Funksionet e Departamentit/Njësisë së Prokurimit dhe nenin 18 Dosja e Tenderit nga Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik.

Konsiderojmë se shkelje të tilla, nuk duhet lejuar në procedura të prokurimit, andaj Agjencia kundër Korrupsion rekomandon që në të ardhmen të shmangen praktikat e tilla.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt!